

Kudusi LAME

Lufta e Jasharajve dhe vlerat e saj

Përgatitja e portretit të heroit kombëtar në figurën e Adem Jasharit

Lufta e Jasharajve ndodhi kur Kosova kishte mbërritur në një gjendje agonie, ku vetëm një rigjenerim i brendshëm mund ta shpëtonte nga vdekja, që po i vinte fshehtas e pa u ndjerë. Dhe shpëtimi i erdhi. Në këtë situatë të vështirë kombëtare do të vinte në ndihmë Adem Jashari dhe tërë familja e tij, të cilët bënë një përmbyesje të vërtetë, të pabesueshme, duke e nxjerrë kombin nga ajo gjendje e vështirë psikologjike dhe e rrezikshme.

Adem Jashari do t'i shpallte luftë Serbisë, duke e bërë përfundimisht këtë luftë të dyanshme, pasi Serbia atë ua kishte shpallur shqiptarëve prej një shekulli. Kësaj shpalljeje lufte nga Adem Jashari, i kontriboi gjithë populli shqiptar i të gjitha trevave, veçanërisht shqiptarët që banonin dhe kishin banuar në trojet e veta nën ish-Jugosllavi. Ky popull i martirizuar vuri tërë potencialin e vet njerëzor e financiar në interes të kësaj lufte, për t'ua mundësuar atyre që rrëmbyen armët, të kapërcenin dispropocionet e mëdha që ata kishin kundrejt ushtrisë, policisë e paramilitarëve dhe kriminelëve që kishte angazhuar Serbia në Kosovë, për të masakruar shqiptarët e pastruar kombëtarisht trojet e pushtuara shqiptare.

Adem Jasharit i përmbyesi të gjitha synimet politike serbe, por edhe të politikave të shqiptarëve luajalë, të cilët ishin të gatshëm të

sundonin shqiptarët ani pse nën Serbi. Me veprën e tij dhe të familjes së tij, e theu heshtjen dhe e hodhi tej durimin politik, duke bërë që të fuqizohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sipërmarrësja e luftës që na solli çlirimin nga pushtimi shekullor.

Adem Jashari u shndërrua në ndërmjetës, në shpëtimtar të shpëtimit të popullit të tij; u shndërrua në mishërim i lirisë së shqiptarëve dhe të gjitha këto e shndërruan atë në simbol të Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe të kombit shqiptar, në simbol të komandantit të Ushtrisë të asaj lufte.

Adem Jashari dhe fisi i tij, duke u vetëflijuar në mënyrë heroike, i dha mesazh gjithë popullit shqiptar në të gjitha trevat etnike kombëtare: mos të përulemi, por të rrëmbejmë armët dhe të qëndrojmë fortë përballë armikut, se ky është kodi moral i shqiptarit, ndryshe do të bëhemi skllëvër në tokën tonë.

Adem Jashari me veprën e tij, u tha shqiptarëve, se: për të arritur fitoren duhet të krijojmë unitetin mbarëkombëtar, të unifikojmë mendimin se liria fitohet me qëndresë, pasi kurrë nuk dhurohet. Flijimi i Jasharajve i dha Kosovës me mijëra njerëz të gatshëm të sakrifkoheshin për të, për lirinë e saj, duke bërë luftë pa u ndalur deri në fitore.

Adem Jashari dha mesazhin se luftëtari i lirisë është mbi çdo njeri që bën deklaratat patriotike, që propagandon paqen nën pushtim, se luftëtari është më i vlefshëm se çdo ministër, deputet, politikan e se çdo intelektual që e kërkon lirinë me mirëkuptim me pushtuesin.

Jasharajt, duke u ndeshur me një ushtri të tërë, ngjallën shpresën tek të gjithë shqiptarët e vërtetë, se fitorja e lirisë është e mundur. Ata

me qëndresën e tyre ia hoqën popullit shqiptar të Kosovës turbullimin që e kish përfshirë.¹

“Pasi pushtuesi u bie në gjurmë djemve që ishin në Shqipëri për ushtrime luftarake, - do të tregojë Rifat Jashari - fillon menjëherëndjekjen dhe arrestimin e tyre”.²E pikërisht në këtë kohë do të sulmohet nga forcat ushtarako-policore serbe edhe familja e Shaban Jasharit. Në këtë rast u bë një luftë disaorëshe, që ishte paralajmërim se po vinte dikush që kishte guximin të qëndronte përballë forcës ushtarake të Serbisë dhe se kishte guximin t’i vriste serbët që e sulmonin, duke u treguar shqiptarëve se edhe ata i merr plumbi i shqiptarit.

“Gjatë shpërthimit të rrethimit, - vijon të tregojë Rifat Jashari - Ademi më luti që të mos hyjmë nëpër oborre të fqinjëve, sepse nuk donte që për shkakuntonë fqinjët të dëmtohen nga armiku. Aty ku dolëm, erdhën menjëherë Fadil e Ilaz Kodra, Sahit Jashari e disa të tjerë. ... Me të dalë në anën tjetër, Ademi ka filluar t’i gjuajë armiqtë. Gjuajtjet e dyanshme me armë kanë vazhduar edhe me tej, ndërsa armiqtë na gjuanin edhe me mitraloz të rëndë nga tanku. Menjëherë kanë filluar të vijnë te ne njerëz të armatosur nga Prekazi, nga të gjitha anët e Drenicës dhe më gjerë. U mbush mali. Secili që kishte ardhur, kishte armë në dorë. Te ne pastaj kanë ardhur Gani Syla, Jakup Krasniqi, Gani Kocietj. Megjithatë, unë vonë jam takuar me ta, sepse, më shumë kam qëndruar me grupin e njerëzve që kishin ardhur me armë, ndërsa Ademi ka qenë më tepër në lëvizje, prej njëpozicioni

¹http://pashtriku.beepworld.de/files/Histori/28nventori/dilaver_goxhaj_flijimijasharajve_01.12.07.htm (15.11.2017)

²<http://www.forumishqiptar.com/threads/13596-Adem-Jashari-Hero-i-Kosov%C3%ABs> (15.11.2017)

në tjetrin. Hamza gjithashtu ka qëndruar me një grup tjetër burrash të armatosur”.³Panoramë kjo, që na krijon idenë se po përgatitej portreti i heroit kombëtar në figurën e Adem Jasharit.

Dhe cila ishte gjendja kur lufta e shpallur nga Adem Jashari po shtrihej në gjithë vendin, prapë i referohem Rifat Jasharit i cili tregon: “Hamza ka thënë disa herë se “akademikët tanë, udhëheqësit tanë, doktorët e shkencave janë në gjumë”. Ata thoshin se nuk dinë si të takohen me Ademin, ndërsa Ganiu u tha: “Unë ua gjej atë dhe nëse doni u dërgoj në kullë, ose në shtëpinë time për t’u takuar”. Ata e kishin brengën çka nëse zbulohen prej pushtetit. Për këtë arsye, ma merr mendja se nuk kanë guxuar të takohen me Ademin. Kështu ishte. Mëvonë u krijuan dy taborë në Kosovë: njëri që përmes politikës mendonte se do të rregullohet gjithçka dhe krahu ushtarak, i cili mendonte se pa e rrokur pushkën nuk do të ketë asgjë”.⁴ Nuk mendoj se ka nevojë për arsyetime me të hollësishme nga unë, për të bërë të qartë gjendjen e krijuar në atë kohë në Kosovë dhe se si po përgatitej çlirimi nëpërmjet asaj lufte të shpallur nga Adem Jashari.

Duke iu referuar përsëri Rifat Jasharit, krijojmë bindjen e plotë të fuqisë morale të familjes Jashari, si një njësi e gatshme për ta bërë luftën për hatër të atdheut. Rifati thotë: “Dikush, këtu, në këtë kullë, më ka pyetur mua dhe kam dëgjuar se edhe babës i kanë thënë: “Kur e ka pasur ndërmend Ademi të luftojë, pse nuk i ka larguar fëmijët dhe gratë nga shtëpia?”. I kam thënë: “O zotëri, unë ta kisha dhënë përgjigjen, por mua nuk më takon të flas, pasi s’kam qenë në shtëpi në atë kohë”. Por, të tjerët kanë treguar se nuk ka pasur forcë që e largon

³Po aty.

⁴<http://www.forumishqiptar.com/threads/13596-Adem-Jashari-Hero-i-Kosov%C3%ABs> (15.11.2017)

as një fëmijë të vetëm nga shtëpia jonë, e për të rriturit të mos flasim fare. Kjo që ka ndodhur në familjen tonë s'ka qenë e rastësishme, sepse të gjithë ishim të përgatitur psikologjikisht për çdo punë".⁵Prej këtej, duket qartë vlera e qëndresës së Jasharajve dhe mesazhi që ata u dhanë shqiptarëve me luftën e tyre.

Fenomeni Adem Jashari, ka ndodhur vetëm njëherë, ka ndodhur në kohë dhe hapësirë të caktuar, ka ndodhur në momentin vendimtar të historisë sonë.⁶Për të krijuar mekanizmin që mund të çlironte vendin nga pushtimi dhe ta shpëtonte atë nga pastrimi etnik e kolonizimi përfundimtar i saj. Vizioni politik i Adem Jasharit, ndërsa është i mbështjellë me konfigurimin e armës, ka në thellësinë e vetë mendimin e qartë se lufta ishte e domosdoshme, pasi nuk do të kishte rrugë tjetër dhe, së dyti, kjo luftë duhej bërë, frontale, ballë për ballë me forcat ushtarako-policore serbe,⁷ që të krijohej bindja te shqiptarët se edhe serbët mund të detyroheshin me forcë të shkonin andej nga kanë ardhur.

Për t'i vënë në pah vlerat e kësaj lufte viganësh, akademiku i nderuar Rexhep Qosja, do të shprehet: "Por, ç'të them për luftën e UÇK-së dhe për bëmën e Adem Jasharit dhe të familjes së Jasharajve? Do të them: ajo nuk është bëmë e zakonshme. Ajo është bërë historike. Si e tillë ajo ka domethënie të madhe, me shtrirje të gjerë në hapësirën kombëtare dhe me shtrirje të gjatë në kohën kombëtare. E siç e dimë, shtrirje të tillë, të pakufizuar në kohë dhe të pakufizuar në hapësirë,

⁵<http://www.forumishqiptar.com/threads/13596-Adem-Jashari-Hero-i-Kosov%C3%ABs/page2> (20.01.2018)

⁶*Po aty*(20.01.2018)

⁷<http://www.forumishqiptar.com/threads/13596-Adem-Jashari-Hero-i-Kosov%C3%ABs/page4> 16.11.2017

kanë mitet. Kemi të bëjmë pra, me një bëmë reale, që pashmangshëm merr kuptimin e bëmës për të gjitha kohët: është tepër e pazakonshme, tepër e jashtëzakonshme, tepër përshtypjelënëse në ndjenjat dhe në vetëdijen e njerëzve. Si e tillë ajo nuk mund të çmitizohet kurrë!

Adem Jashari me vetëflimin e tij, e të familjes së tij, të bërë në kushte të jashtëzakonshme dhe në mënyrë të jashtëzakonshme..., tregoi se populli shqiptar është popull historikisht i pjekur për të bërë sakrificat më të shtrenjta për liri.

Mënyra e vetëflimit të Adem Jasharit dhe të familjes së tij, u përcollti të huajve një mesazh shumë të rëndësishëm për popullin shqiptar, që i bëri të mendonin, se: populli me këso vendosmërie, me kësi morali, me kësi karakteri, nuk mund të mbahet i pushtuar gjatë, pavarësisht prej dhunës dhe pavarësisht prej krimeve që mund t'i bëjë pushtuesit".⁸Prej këtij duket më se i plotë portreti i Adem Jasharit në përsosjen e pasqyrës kombëtare shqiptare.

Jasharajt në luftë të vazhdueshme me pushtuesin

Pasi shërbimet sekrete serbe i bien në gjurmë formacionit të armatosur të Adem Jasharit ia mësyn rrethimit dhe kapjes së tij. Më 30 dhjetor 1991, ekspedita ushtarako-policore serbe, ndërmori aksion për zënien e grupit. Por, këta veprimtarë nuk ishin armatosur dhe nuk kishin stërvitur për t'u dorëzuar, siç shprehej vetë Adem Jashari.

⁸<http://www.forumishqiptar.com/threads/13596-Adem-Jashari-Hero-i-Kosov%C3%ABs/page5> (17.11.2017)

Adem Jashari, vëllai i tij që kishte qëlluar në pushime, Rifati, pastaj Hamëz Jashari, Fadil Kodra, Ilaz Kodra dhe Sahit Jashari, vendosin që të luftojnë dhe ta çajnë rrethimin me çdo kusht. Pavarësisht se policia kishte angazhuar numër të madh njerëzish, madje edhe teknikë të rëndë, autoblinda dhe helikopterë, por nuk arrin t’i mposhtë luftëtarët. Kjo ngjarje bëri jehonë të madhe.

Nga shumë anë të Drenicës, atë ditë dhe atë mbrëmje, kishin lëvizur njerëz që ishin të gatshëm për t’iu bashkangjitur rezistencës së Prekazit. Pas kësaj përleshjeje me forcat serbe, grupi i Adem Jasharit kalon në ilegalitet, deri në fillimet e luftës çlirimtare në Kosovë.⁹

Forcat ushtarako-policore serbe me njësitet e tyre speciale, organizojnë një sulm mbi shtëpinë e Jasharajve edhe, më 22 janar 1998. Sulmi nisi në orët e hershme të mëngjesit, ishte i rrufeshëm, por hasi në rezistencën dhe gatishmërinë e madhe të familjes Jashari, e cila ishte e përgatitur dhe gjithnjë kujdestaronte ditë e natë.¹⁰Sepse, siç do të thotë e vetmja e shpëtuar nga lufta e Jasharajve, vajza e vogël Besarta, “Sa këndonte balë Adem hiç nuk kam pas frikë”.¹¹

Kjo luftë e vazhdueshme ndaj kësaj familjeje të madhe e këtij fisi me zë, bëhej sepse armiku dëshironte qoftë edhe largimin e Jasharajve nga trojet e tyre.Pasi do të ulnin përfundimisht nivelin e qëndresës përballë pushtimit, por Jasharajt nuk i lëshonin trojet stërgjyshore. Ata as të vdekur nuk donin të shkuleshin nga vendi i tyre, për çka kishin nisur luftën. Adem Jashari dhe gjithë Jasharajt, nuk e donin ikjen e poshtërimin, ata e dëshironin qëndresën, e donin lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Lufta për Prekazin qe e ashpër. Qëndresa ishte e madhe.

⁹<https://ademjashari.rks-gov.net/sq/adem-jashari> (12.11.2017)

¹⁰<https://ademjashari.rks-gov.net/sq/adem-jashari> (12.11.2017)

¹¹<http://www.tiranaobserver.al/a-mund-te-zihej-gjalle-adem-jashari/> (12.11.2017)

Me aktin e luftës heroike të Jasharajve, Kosova mundi frikën dhe për lirinë e pavarësinë u hapen shtigje të reja.¹²

Në historinë e kombeve, si dhe në historinë e kombit tonë, ka jo pak shembuj, për të mos thënë se ka mjaft të tillë, në të cilat sakrificat sublime, qëndresa, përkushtimi, janë shfaqur si simbole nga të cilat është mbajtur gjallë historia.

Por, rasti i familjes Jashari është i një natyre krejt të veçantë. Për t'u ngritur miti i tyre nuk u deshën vite të shumta e as dekada, nuk u desh që të trasohej rruga, të qetësoheshin ngjarjet, të merrnin rrugë ato; miti i tyre u ngrit vetvetishëm dhe kjo ndodhi që të nesërmen e rënies së tyre. E mitet lindin gjithnjë për njerëz që kthejnë për së mbari historinë dhe jetën e një kombi.

Serbia kishte bërë gati rreth 8000 trupa elitë për rrethimin e madh, të tretin të Jasharajve. Adem Jashari ishte bërë gati të niste luftën e madhe. Serbia thirrej e çirrej se këtu kishte qenë djepi i saj, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kërkonte asgjë më shumë se sa të gjithë popujt e botës: mëvetësinë në trojet e veta, shtetin e tyre, bashkimin e kombit. Ishte një dëshirë tejet fisnike e njerëzore, të cilën mund ta sjellin vetëm ata që janë të denjë për t'u flijuar në emër të saj.¹³

E ky rrethim i tretë, ishte vazhdimësi i rrethimit të parë, më 30 dhjetor të vitit 1991 dhe të rrethimit të dytë, më 22 janar 1998.

¹²<http://lajmpress.com/horoskopi-4-mars-2017/> (12.11.2017)

¹³<http://floripress.blogspot.al/2011/03/shkruan-bedri-islami-adem-jashari-miti.html> (12.11.2017)

Përgatitjet e Serbisë për nënshtrimin përfundimtarë të shqiptarëve

Përgatitjet e Serbisë (ish-Jugosllavisë) për likuidimin përfundimtar të idesë së shqiptarëve në Kosovë për liri, nuk ishin fillestare e të panjohura. Ato përgatitje përfshinin edhe shfarosjen e shqiptarëve më të qëndrueshëm dhe të pafriksueshëm. Kjo sepse ishte bërë një punë intensive propagandistike dhe shtypëse, për të krijuar idenë se serbët në Kosovë si pushtues ishin të përjetshëm dhe se çdo tentativë për t'iu kundërvënë pushtimit, sillte pas vetes një masakër. Por, si pushtuesi, ashtu edhe politika legale e nënshtrim-durimit, nuk kishin marrë në konsideratë historinë e qëndresës shqiptare dhe të luftës për liri, nuk kishin vlerësuar se përfundimisht në gjithë historinë, shqiptarët i kanë detyruar pushtuesit të ikin. Nuk kishin marrë në konsideratë gatishmërinë e popullit shqiptar, për të kundërshtuar masivisht me armë, pushtimin fashist të trojeve të tyre nga Serbia.¹⁴

Gjendja e krijuar në Evropë pas rënies së Murit të Berlinit, kishte krijuar të gjitha parakushtet, që edhe shqiptarët të ngriheshin për të drejtat e tyre të vetëvendosjes. Por, orientimi i kërkesës së këtyre i të drejtave universale nëpërmjet kërkesës e lutjes, që pushtuesi të ndërjegjësohet, për t'i dhënë ato për shqiptarët në trojet e tyre të pushtuara e veçanërisht në Kosovë, u pa se ishte një orientim i gabuar dhe humbje kohe. Prandaj, edhe krijimi i parakushteve për të fituar lirinë me luftë të armatosur, ishte konsideruar nga shqiptarët që i besonin vetvetes, si detyrë parësore. Kjo bëri të mundur që të gjithë ata

¹⁴*Historia e artit ushtarak shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1939*, Tiranë 2001, f. 323.

shqiptarë, të cilët i njihnin dhe i vlerësonin fuqitë kombëtare, si të afta për t'iu kundërvënë pushtimit, të organizoheshin për të realizuar këtë detyrë. Këta shqiptarë, duke mos e pranuar depërtimin e gjerë ekonomik dhe politik të Serbisë në Kosovë dhe duke iu kundërvënë atij, krijuan forcën e tyre të armatosur, që u quajt Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Me gjithë dëshirën e madhe që kishte Serbia për të kolonizuar përfundimisht Kosovën, shikonin se populli shqiptar ishte pengesë e vështirë, por sipas vlerësimit të regjimit fashist, jo e pakapërcyeshme. Për të përballuar çdo kundërshtim të tij, fashistët e Beogradit shpërthyen në shkallë të gjerë agresionin ideologjik, kulturor, fetar, shkencor e politik dhe mobilizuan agjenturën dhe reaksionin shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Si rezultat i kësaj pune, u pa një frikësim masiv i shqiptarëve, ndihmuar edhe nga politika legale vendore e durimit dhe pritjes, se pushtuesi do të bëhet një ditë zemërmirë e do të habitet me veten, si paska qenë e mundur, që të mbahen shqiptarët të pushtuar dhe pasi t'u kërkonte falje, do t'u dhuronte edhe lirinë.

Ndërkohë, qeveria e Beogradit shtoi përpjekjet për dobësimin e mëtejshëm të shpirtit luftarak të shqiptarëve. Ashtu sikurse edhe politika legale vendore bënte përpjekje, që të urtësonte shqiptarët dhe t'i deklaronte të papërgjegjshëm, të gjithë ata që e kundërshtonin Serbinë me protesta a me armë.¹⁵

Plani serb i operacionit për nënshttrimin përfundimtar të Kosovës, i hartuar me kohë nga Shtabi i Ushtrisë, parashikonte në fazën e parë, likuidimin përfundimtar të vatrave që vlerësoheshin si më të panënshtuara, duke krijuar mundësi që të arrihej të trembeshin përfundimisht të gjithë shqiptarët. Për këtë, ishin parashikuar një seri

¹⁵*Po aty.*

masakrash familjare e fisnore, duke shfrytëzuar edhe politikën legale, që thoshte se kush i bën rezistencë Serbisë do të bëhet shkas të masakrohet vetë dhe të masakrojë edhe të tjerët. Kurse në fazën e dytë, shtrirjen e sundimit e masakrimit dhe krijimi i kushteve për të bërë pastrimin përfundimtar etnik të gjitha trojeve të pushtuara shqiptare. Por, të gjitha këto plane pavarësisht synimeve serbo-sllave i prish qëndresa popullore.¹⁶

Janari i vitit 1998, solli me vete fundin e paqes mashtruese në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës, ndërtoi një qëndrim për kundërshtimin e aspiratave të shqiptarëve për pavarësi. Mbi këtë bazë, gjatë vitit 1998, Grupi i Kontaktit dhe qendrat tjera ndërkombëtare të vendosjes përmes diplomacisë lëvizëse, do të udhëtonin sa në Beograd e sa në Prishtinë, për të gjetur një zgjidhje politike për Kosovën, përmes negociatave. Robert Geldbard në një nga takimet e tij, më 23 shkurt 1998, me Ibrahim Rugovën në Prishtinë, akuzoi publikisht UÇK-në si organizatë terroriste, ndërsa kërkonte forcimin e lidërshpimit politik të moderuar.¹⁷ Ky veprim i diplomatit amerikan, skajshmërisht akuzues për UÇK-në, në të vërtetë u dha forcë shtytëse në aspektin politik qëndrimeve pacifiste, ndërsa në aspektin ushtarak e trimëroi Slllobodan Millosheviqin, për të marrë një ofensivë për zhbërjen e UÇK-së.¹⁸ Natën e 4 dhe 5 marsit 1998, forca të mëdha policore e ushtarake e kishin rrethuar Prekazin dhe lagjen e Jasharajve. Ndonëse skajshmërisht të pabarabartë, pas tri ditë e tri netësh luftimesh e

¹⁶*Historia e artit ushtarak shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1939*, Tiranë 2001, f. 326.

¹⁷Blerim Shala, *Vitet e Kosovës 1998-1999*, Prishtinë 2001, f.30.

¹⁸Tim Judah, *Kosova, lufta dhe hakmarrja*, Prishtinë 2000, f. 174.

rezistence të armatosur, ranë heroikisht, komandanti Adem Jashari dhe 55 dëshmorë të lirisë. Lufta heroike e Jasharajve pushtoi të gjitha mediat dhe vuri në lëvizje politikën botërore. Më 9 mars, Grupi i Kontaktit miratoi një deklaratë për Kosovën, e cila dënonte Beogradin dhe e paralajmëronte se do të merren masa shtrënguese. Pas ngjarjes së Prekazit, në një takim me Slobodan Millosheviqin, në Beograd, Robert Gillbard i kishte thënë atij se “duke sulmuar popullsinë civile, në përpjekjet e tij për ta eliminuar UÇK-në, ai në të vërtetë po shndërrohej në agjentin e UÇK-së për rekrutim”.¹⁹ Ndërsa, Ibrahim Rugova, deklaronte se: “Në Kosovë nuk mund të ketë luftë normale, por mund të ketë vetëm masakër. Serbët për dy ditë do të mund të na shkatërrojnë të gjithëve”.²⁰ Kjo ishte një tërheqje vëmendje për qytetarët e Kosovës, që të uleshin e të pranonin fatin që kishte ruajtur koha për ta.

Operacioni ushtarak serb në Prekaz

Operacioni ushtarak serb në Prekaz futi përfundimisht në luftë shqiptarët kundër Serbisë dhe vuri përballë dy synime diametralisht të kundërta: synimin e shqiptarëve për të fituar lirinë dhe atë të Serbisë për të zhdukur shqiptarët, si dhe vuri në provë dy metoda lufte që ndryshonin rrënjësisht njëra nga tjetra,²¹ luftën për çlirim kombëtar me atë të masakrimit të civilëve në pamundësi për t’u hakmarrë ndaj luftëtarëve të lirisë, të përdorur në vazhdimësi nga ushtria e policia serbe.

¹⁹Wesli K. Clark, *Të bësh luftë moderne*, Prishtinë 2003, f.141.

²⁰Intervistë e Ibrahim Rugovës, në radio “Deutche Vele”, 07.3.1998.

²¹*Historia e artit ushtarak botëror*, Tiranë 1987, f. 332.

Sulmi kundër Jasharajve dhe masakrimi i të gjithë të rrethuarve, përbënin kursin themelor të politikës dhe të strategjisë së Serbisë fashiste për të sunduar Kosovën. Kjo shpjegohet për shumë arsye: të pabindurit e të panënshtuarit, si Jasharajt e të tjerë, ishte pengesa kryesore për zbatimin e politikës grabitqare të Serbisë; mbajtja nën sundim e Kosovës me rezervat e saj shumë të mëdha materiale do të rriste fuqinë ekonomike të Serbisë; duke sulmuar Jasharajt në Prekaz, si qendër qëndrese kombëtare shqiptare, fashistët serbë mendonin se do të përkëdheleshin e do të përkrاهشin nga fuqitë evropiane e botërore, së fundi, duke e trumbetuar sulmin kundër Jasharajve si luftë kundër terrorizmit, ata synonin të maskonin qëllimet e vërteta - skllavërimin e shqiptarëve dhe sundimin e Kosovës.

Komanda millosheviqiane mendonte se forcat e vendosura në familjen Jashari ishin të pakta dhe do të asgjësoheshin shpejt. Prandaj, plani i luftës kundër familjes e fisit Jashari, nisej nga mendimi se, fitorja që do të arrihej në këtë rajon, do të ishte njëlloj e vlefshme me fitoren kundër të gjithë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Kosovës në përgjithësi.

Komanda e Lartë dhe Shtabi i Përgjithshëm i Serbisë fashiste, qysh në vitin 1989 kishin filluar përgatitjet e gjithanshme për të sulmuar në një moment Kosovën, si: zbulimin, riorgaizimin dhe kompletimin e trupave, përgatitjen e rajoneve, përhapjen strategjike të forcave të armatosura dhe sigurimin e tyre materialo-teknik si dhe një varg masash të tjera.²²Të gjitha masat kishin për qëllim që të siguronin dhënien e befasishme të goditjes së parë shumë të fuqishme kundër bërthamës së organizimit të rezistencës, prej nga do të ndërmerreshin

²²*Po aty.*

në të pastajmen masakra të vijueshme, pa shumë zhurmë, duke u treguar të gjithë shqiptarëve rrugën e mërgimit ose së patën e xhelatit.

Direktiva për luftën kundër familjes Jashari ishte miratua nga Millosheviqi më herët, me paramendim për t'i zhdukur të gjithë, pa bërë përjashtime ishin luftëtarë, ishin burra, ishin gra, ishin pleq a fëmijë. Në të parashikohej asgjësimi i gjithë shqiptarëve të panështrueshëm me anën e një fushate shumë të shpejtë. Me kujdes të veçantë ishte planëzuar etapa e parë e fushatës, ku ishte detajuar çdo element, për të mos pasur asnjë mundësi hyrje e dalje luftëtarësh brenda unazës së rrethimit. “Rrethimi i fisit Jashari, ishte i tillë, sa që nuk kishte asnjë mundësi për të hyrë brenda unazës së rrethimit. Kishte vetëm një mundësi, që të sulmoje e të mbeteshe në rrethim. Prandaj, edhe të gjithë ne që mbetëm jashtë rrethimit, vazhdonim të godisnim forcat. Dhe luftë të tillë nga jashtë ka pasur si nga ne Kodrajt, Lushtakët e më tej”.²³ Ndër të tjera synohej të copëtohej fronti i forcave të UÇK-së në atë zonë, të cilat nëse do të kishin mundësi të vepronin të përqendruara, me goditje të shpejta e të thella të njësiteve të fuqishme, të lëvizshme dhe të mirorganizuara, do të bënë që operacioni për asgjësimin e Jasharajve të dështonte. Por, ky dështim do të thoshte që Serbia nuk kishte më asnjë mundësi ta mbante Kosovën.

Për zbatimin e këtij plani, siç duket, parashikohej zhvillimi i mësymjes së tri grupimeve goditëse në tri drejtime kryesore. Grupimi i parë, i përqendruar në rrethimin e fisit Jashari, duhej të jepte, goditje në drejtimin e përgjithshëm të këtij fisi, por kryesisht mbi familjen e Shaban Jasharit, ku ata e dinin mirë se ishte edhe komandanti Adem Jashari, që konsiderohej më i rrezikshmi dhe që mendohej se me

²³Nga biseda me gjeneralin Fadil Kodra, pjesëmarrës në atë qëndresë jashtë rrethimit. Biseda është kryer, më 23 shkurt 2018.

asgjësimin e tij do të binte në qetësi gjithë Kosova; Grupimi i dytë do të krijonte rrethimin e jashtëm për të përballuar të gjitha sulmet që mund të ndërmerreshin nga luftëtarët e UÇK-së, në tentativë për të shkuar në ndihmë të komandantit; ndërsa Grupimi i tretë, i shtrirë në të gjitha drejtimet e rrugëkalimeve nga mendohej se mund të vinin forca të UÇK-së nga zona të tjera të Kosovës, për t'u ndeshur me ta e për të mos i lejuar të afrohen në drejtim të Prekazit. Përveç këtyre tri grupimeve kryesore, ishin shpërndarë forca edhe në rajonet e tjera, që nga Prishtina e deri në Prizren, Pejë e Mitrovicë, të cilat kishin për detyrë të mos lejonin organizim të forcave për t'i shkuar në ndihmë komandantit.

Zbatimin e këtij plani dhe masakrimin e familjes Jashari, komanda millosheviqiane mendoj se do ta kryente për 3-4 orë. Duke pasur bindjen e plotë për fitoren e shpejtë të kësaj fushate, komandamillosheviqiane kishte hartuar në vija më të gjera edhe perspektivat e zgjerimit të mëtejshëm të masakrave. Këto perspektiva synonin që, duke u mbështetur traumën e krijuar në gjithë Kosovën, të demonstrohej forca dhe të jepej mesazhi se shqiptarët mund të jetonin ose jo, vetëm si të vendoste Serbia.

Zhvillimi i ngjarjeve zbuloi plotësisht karakterin aventuror dhe jo të vërtetë të planit millosheviqian, që parashikonte likuidimin e çdo nisme për të luftuar kundër pushtimit serb dhe përgatitjen e terrenit për ndryshimin e përbërjes demografike të Kosovës.

Për realizimin e planit famëkeq serb, komanda fashiste serbe aktivizoi në Kosovë mbi 8000 trupa dhe vetëm në Prekaz rreth 4000, të pajisura me artileri, tanke, helikopterë dhe kishin mbajtur në

gatishmëri për t'u ngritur edhe aviacionin gjuajtës bombardues, në aerodromin e Prishtinës ashtu edhe në atë të Nishit e Beogradit.²⁴

Përhapja e forcave dhe mjeteve ushtarako-policore u krye sipas një grafiku të përpiktë dhe në kohë të zgjatur, me qëllim që për të siguruar befasinë, përqendrimi i forcave pranë fisit Jashari u duk vetëm para fillimit të sulmit.

Forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nën udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandantit Adem Jashari, duke vlerësuar drejt përgatitjet e ethshme të Serbisë për shpërthimin e një lufte të re kundër shqiptarëve në Kosovë, veçanërisht rrezikshmërinë që paraqiste agresioni i orientuar nga masakrimi i popullsisë, paralel me ndërtimin dhe funksionalizimin e UÇK-së, kishin krijuar të gjitha kushtet e domosdoshme, politike, ekonomike dhe ushtarake dhe morale për fuqizimin e aftësisë për t'u përballur me Serbinë e fituar lirinë.

Rëndësi në atë periudhë kishte edhe shpartallimi i politikës pacifiste që i çonte shqiptarët drejt fatalizmit, duke i konsideruar të paaftë për t'u kundërvënë forcërisht përballë Serbisë. Kjo politikë që vepronte në organet drejtuese të Kosovës, u mundua me të gjitha mjetet të minonte fuqinë ushtarake dhe ekonomike të Kosovës, si dhe të shkatërronte idenë e qëndresës e të luftës së armatosur për të fituar lirinë.

Trupat serbe që rrethuan fisin Jashari, që në një mënyrë kishin kaluar në mësymje, nuk mundën të përparonin asnjë hap në territorin që kontrollohej nga armët e të rrethuarve. Qysh në orët e para të mësymjes së serbëve, të rrethuarit u bënë atyre qëndresë shumë të ashpër. Në orën 05:30 minuta, të datës 5 mars, artileria serbe, nga

²⁴*Historia e artit ushtarak botëror*, Tiranë 1987, f. 333.

Fabrika e Municionit, hap zjarr intensiv në drejtim të Kullës së Shaban Jasharit dhe të të gjithë Jasharajve. Lufta dhe qëndresa titanike e kryetrimave në Prekaz kishte dhënë kushtrimin në të gjitha trojet e Shqipërisë dhe në mërgatë.

Anteu i lirisë, Adem Jashari, kishte marrë vendimin historik, vendimin më të vështirë dhe më të dhembshëm që ka marrë ndonjëherë njeriu, gjatë tërë historisë së qytetërimit.

- Nuk do të dorëzohemi për së gjalli!

- Vrastarët nuk do të kalojnë, veçse mbi trupin tim të vdekur!

Prandaj, lubia serbe kishte provuar disa herë ta kafshonte Drenicën: në Prekaz, në Llaushë, në Likoshan, në Qirez e sërish në Prekaz. Më 5 mars, ajo po rikthehej edhe një herë te Prekazi i legjendave të trimërisë, për ta kafshuar helmueshëm Drenicën. Po sulmohej kështjella e Jasharajve, ku ruhej i paprekur nderi shqiptar. Ajo kishte brenda zemrën e madhe të komandantit legjendar të luftës për liri, Adem Jashari, plakut fisnik Shaban Jashari, trimit të paepur Hamëz Jashari, nipave dhe mbesave të Shotës. Mëngjesi i asaj dite të acartë marsi, bashkë me krismat dhe me zjarrin e topave, po derdhte mbi Prekaz edhe tërë llahtarinë e barbarisë serbe. Por, atë çast, brenda kështjellës u mor vendimi i madh:

- Nëse duhet vdekur dikush, më mirë unë, sesa Kosova ime, - kishte thënë komandanti.

- Nëse duhet vdekur dikush, më mirë të gjithë ne, sesa Atdheu, - kishin thënë të gjithë Jasharajt në kështjellë.

Po shkrepnin pushkët, e po këndonte zemra shqiptare. Pushka dhe kënga e trimave po shkruanin simfoninë e qëndresës së pamposhtshme, jehona e tyre po prekte rrënjët dhe majën e historisë së luftës sonë për liri. Në Prekaz po bëhej historia. Kështjella e Jasharajve

po bëhej muranë e lirisë.²⁵Sepse ishte e qartë, sesulmi në familjen Jashari nuk kishte vetëm qëllimin e zhdukjes së një familje shqiptare dhe vrasjen e komandantit të UÇK-së, por, qëllim kryesor kishte vrasjen e guximit të shqiptarëve, për të luftuar për çlirim e bashkim kombëtar.²⁶

Gjatë 3 ditëve të luftimeve, trupat fashiste serbe u shkaktuan humbje të rënda trupave shqiptar brenda rrethimit. Po gjatë kësaj kohe, edhe trupat fashiste pësuan humbje të mëdha.²⁷ Të rrethuarit, duke bërë qëndresë të ashpër, ngadalësuan vrullin e forcave serbe dhe dhanë goditje të fuqishme.

Komanda millosheviqiane e kuptonte rëndësinë e Jasharajve jo vetëm si qendër kryesore e politikës luftarake për çlirimin e Kosovës, por edhe si kështjella me rëndësi të madhe morale për shqiptarët.

Lufta e trupave shqiptare në rrethim ishte aktive, e ashpër dhe në më të shumtën e rasteve përfundonte me dëme të mëdha njerëzore te forcat rrethuese ushtarake-policore serbe.

Organizimi dhe zhvillimi i veprimeve luftarake të forcave të rrethuara nuk kishte hapësirë krijimi manovrash të shumëllojta. Aty kishte një hapësirë e cila ishte nën kontrollin e rrethuesve, por që edhe të rrethuarit mbanin gjithnjë kontroll të pandërprerë.

I vetmi ndryshim situatë mund të vinte nga ndonjë mundësi ndërhyrjeje të strukturave a njësiteve të UÇK-së nga jashtë rrethimit. Një ndihmë shumë e çmueshme mund të vinte edhe nga qytetarë

²⁵<http://www.radiokosovaelire.com/adem-shaban-jashari-28-11-1955-7-3-1998/> (12.11.2017)

²⁶<https://ademjashari.rks-gov.net/sq/historia-e-familjes> (12.11.2017)

²⁷*Historia e artit ushtarak botëror*, Tiranë 1987, f. 337.

shqiptarë që mund të kishin armë. Por, të rrethuarit nuk kishin parasysh se sa forca ishin përqendruar në këtë rrethim, duke u kujdesur që të rrethuarit të ishin vetëm.

Prekazin e piketoi Serbia, si vendin ku duke goditur fort, shqiptarëve do t'u jepej një mësim që nuk do ta harronin kurrë, ndërsa vetë Serbia duke e fshirë Prekazin do ta harronte që të nesërmen atë emër.

Dihet që Prekazi e në veçanti familja Jashari përbënte një bazë të fortë të luftës çlirimtare të Kosovës. Tashmë armiku kishte arritur të marrë njohuritë e nevojshme për të përcaktuar se UÇK-ja që kishte filluar të vepronte në gjithë Kosovën kishte një qendër force e morali që e udhëhiqnin e cila ishte në Prekaz, ishte në familjen Jashari dhe ishte portretizuar në figurën e atij që kishte bërë rezistencë me armë prej një dekade - Adem Jasharit. Për këtë edhe duhej goditur pikërisht këtu në qendrën e forcës, të moralit dhe të lidhjes.

Aty bëheshin takime e merreshin edhe vendime për operacione, që bënin jehonë në të gjitha anët e Kosovës e më gjerë.

Kuptohet që Prekazi edhe në pikëpamje të terrenit ishte shumë favorizues për të ndërmarrë veprime luftarake. Ashtu sikurse ishte një urë lidhëse e Dukagjinit me trevat e tjera të Kosovës.

Për ta asgjësuar këtë qendër të rrezikshme për të, armiku planifikoi dhe organizoi operacionin kundër Prekazit, që do të fillonte në mëngjesin e datës 5 mars 1998, në të cilin sipas planifikimit u përdorën të gjitha llojet e armëve që dispononte armiku, përveç raketave dhe lëndëve helmuese luftarake. "Ishte kjo luftë që zhvillohej me armatim dhe forca jo të barabarta. Armiku kishte forca shumë e shumë më të mëdha në numër dhe përdorte armë të shumëllojshme dhe

më moderne të kohës, krahasuar me numrin e luftëtarëve tanë dhe armatimin që përdornin ata”.²⁸

Qëllimi i këtij operacioni ishte i qartë: të asgjësohej kjo qendër udhëheqëse e luftës çlirimtare dhe të bëhej një masakër mbi popullsinë e paarmatosur, që të ishte tmerr dhe mësim për gjithë shqiptarët, që ata të mos guxonin më të mendonin për të luftuar kundër armikut, jo edhe të vepronin.

Plani ishte përpunuar me te gjitha hollësitë. Sipas parashikimit, paniku pas këtij operacioni tek shqiptarët do të ishte shkatërrues. Formacioneve të UÇK-së do t’u shkëputej lidhja dhe do të ishin të detyruar të iknin; populli nuk do të donte të kishte asnjë lidhje me ata që konsideroheshin luftëtarë të UÇK-së; ata që do të mbeteshin, do të izoloheshin dhe do të asgjësoheshin një nga një. Kosova përfundimisht do të merrte rrugën e shpopullimit prej shqiptarëve dhe do të bëhej pronë serbe.

Duke filluar mësymjen në mëngjesin e 5 marsit 1998, forcat e armikut të mbështetura prej artilerisë dhe tankeve, e futën Prekazin në një darë rrethimi, duke bllokuar edhe të gjitha rrugët e mundshme të ardhjes së ndihmave prej njësiteve të tjera luftarake nga jashtë Prekazit.

Operacioni do të vazhdonte 3 ditë, duke vrarë pa mëshirë çdo person që dukej brenda ombrellës së rrethimit, pa bërë dallim nëse ishin ose jo të armatosur. Masat rrethuese ishin shumë të forta e të dendura, për të mos lejuar asnjëri të dalë i gjallë nga rajoni i rrethuar.

Qëndresa e luftëtarëve brenda rrethimit ishte shumë e madhe. Një qëndresë të tillë armiku ndoshta nuk e kishte parashikuar. Aty u bë luftëtar çdo njeri që u ndodh në fshat. U bënë luftëtarë edhe fëmijët pesëvjeçar, edhe pleqtë mbi 80-vjeçar. Kjo i dha asaj lufte përmasa

²⁸Ibrahim Çitaku, *Prekazi*, Prishtinë 2003, f. 118.

epokale. “Qëndresa dhe heroizmi i Jasharajve për t’i vënë me jetërat e tyre, gurthemelet e historisë së re të Kosovës, si dhe veprimet e rrufeshme luftarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Drenicë dhe në Dukagjin, duke u shkaktuar humbje në njerëz dhe në teknikë, njësiteve elite serbo-jugosllave, bënë ndikim të dukshëm në opinionin shqiptar dhe ngjallën shpresën se gjenerata e djemve dhe vajzave të Kosovës, që vepronin në kuadër të formacioneve të UÇK-së do t’ia kthejë popullit vetëbesimin, nderin dhe dinjitetin e shkelur nga okupatori dhe veglat e tij”.²⁹

Ditën e dytë të operacionit armiku i fuqizoi akoma forcat e tij. Ndërkohë u morën masa të forta me përqendrim forcash e mjetesh edhe në zonat përreth, që të bëhej trysni për të mos lejuar të hapeshin fronte të tjera luftime. “Armiku nuk zgjidhte mjetet, vriste njerëz dhe digjte e shkatërronte çdo gjë para vetes”,³⁰ do të rrëfente Besarta Hamëz Jashari.

Për të ruajtur fshehtësinë e asaj që po ndodhte në Prekaz, u mbajtën larg edhe të gjitha mediat. Nuk u lejua të depërtohej brenda rrethimit për asnjë rrethanë askush. Gjithkush që tentoi të shkonte drejt Prekazit u ndalua dhe u kthye prapa. Për 3 ditët që vazhdoi operacioni nuk u dha asnjë informacion mediatik. Kosova diku mbeti e panjohur me çfarë po ndodhte e diku mbeti në pritje të përfundimit të këtij akti masakruës.

Lufta treditore në operacionin kundër Prekazit e tronditi armikun. Ai kishte besim se me forcën që kishte, mund të bënte luftëra të mëdha, por ky operacion tregoi se armiku nuk kishte energji për

²⁹TahirGecaj, *Kolona s’ndalet...!*, Prishtinë 2001, f. 13.

³⁰IbrahimÇitaku, *Prekazi*, Prishtinë 2003, f. 158.

ndeshje frontale me formacione ushtarake. Këtë konkluzion nxori edhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që në momentet e para të përfundimit tragjik të këtij operacioni.

Pra, ushtria dhe policia e armikut me forca të mëdha ju deshën tre ditë të luftonte vetëm me një grusht luftëtarësh. Por, megjithëse ata luftëtarë në këto tre ditë të operacionit, u vranë të gjithë, armiku doli i humbur, sepse ai nuk arriti të tregojë se është i fortë, synim të cilin donte të arrinte me këtë operacion të organizuar për ta realizuar brenda disa orësh.

Armiku nuk arriti ta likuidojë UÇK-në, siç e kishte planifikuar. Përkundrazi, ajo nuk u lëkund, me gjithë dhembjen që ndjeu për humbjen e komandantit të lavdishëm dhe të masakrës që u bë në atë operacion në Prekaz mbi Jasharajt. Të vërtetën e plotë do ta zbulojnë dhe mund ta zbulojnë vetëm studiuesit që do të kenë fatin të shfletojnë arkivat serbe për këtë operacion kur ato të hapen.

Armiku merr goditje në gjithë vendin

Rënia e Adem Jasharit nuk u përjetua si një vdekje, por si një lindje kombëtare. Nuk u përjetua si një mort, por si një sinjal, për t'u ngritur të gjithë në këmbë për liri. Mesazhin e parë do ta jepte Rifat Jashari përpara gjithë botës në momentet e para pas rënies nga Gjermania kur do të deklaronte: “Humba një familje, por fitova një komb”.

Pas betejës së Jasharajve, armiku u gjend mbi mina në gjithë Kosovën. Goditjet që merrte ishin të gjithanshme. Njësitë e UÇK-së që vepronin në Kosovë u fuqizuan ndjeshëm. U krijuan njësi të tjera, ku lufta mori përmasa dërmuese për armikun.

Veprimet luftarake të forcave të UÇK-së u bënë shumë më dinamike. Rënia e dëshmorëve të Prekazit u kthye në një uragan kombëtar. Filloi një goditje e gjithanshme e forcave serbe në të gjitha krahinat. Goditeshin stacionet e policisë, njësitë ushtarake në kolona, në vend përqendrime, në kazerma etj. Filloi një stërvitje masive e djemve dha vajzave që u paraqitën në radhët e UÇK-së për t'i aftësuar ata në përdorimin e armëve.

Furnizimi me armatim e municion mori përmasa të mëdha. Ai realizohej me krah dhe me kuaj, por edhe ashtu arrihej të sigurohej një sasi e mirë e armëve dhe municioneve të lehta. U shfrytëzua mirë edhe përhapja e armëve në Shqipëri. Ata bliheshin me çmime relativisht të prej atyre që i kishin grabitur nëpër depot e ushtrisë në vitin 1997. Por, armët vinin edhe prej Evropë e Amerikë. Kuptohet prej andej vinin armë moderne.

Një punë e mirë u bë edhe për komunikimin. Furnizimi me radio për ndërlidhje të brendshme për njësitë dhe me telefona satelitorë për lidhje të brendshme dhe të jashtme luajti një rol mjaft të rëndësishëm në dinamikën e luftës. Ky komunikim ka ndikuar mjaft që njësitë të mbështesin njëra-tjetrën në operacione dhe për vendosjen e hierarkisë ushtarake në radhët e UÇK-së.

U krijuan baza të UÇK-së në gjithë territorin e Kosovës dhe në Shqipëri. Në këto baza bëhej grumbullimi i vullnetarëve, organizohej stërvitja e tyre sipas programeve të përshpejtuara që kishin ndërtuar shtabet dhe u ndërmorën mjaft organizime për t'i dhënë ushtrisë pamjen e një ushtrie serioze dhe me një rregull e disiplinë të nivelit të lartë në kushtet e luftës.

Në të gjitha anët e Kosovës filloi një kërkesë e përshpejtuar për të siguruar armë. Të gjithë vraponin pas armëve. U krijua bindja

përfundimisht se vetëm arma mund të ishte shpëtim për çdo shqiptar. Burime të sigurimit të armëve u bënë Shqipëria, ushtria dhe policia e armikut, shtetet evropiane dhe Amerika. Të gjithë ato kursime monetare që i kishin ruajtur për një ditë të zezë, po i nxirrnin dhe po i kthenin në armë. Mbështetja financiare për luftën ishte në nivel të ultë. Megjithatë fondi “Vendlindja thërret”, kishte filluar të funksiononte dhe të dërgonte sasi të parave për nevojat më imediate. Përvoja tregoi se edhe me këtë fond, me gjithë përkushtimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për të ruajtur çdo cent, pati individë që nuk e zbatuan me rreptësi hierarkinë e grumbullimit të parave, por në mjaft raste u sollën si pronarë të këtyre fondeve, që mendoj se e kanë dëmtuar në masë të konsiderueshme.

Me rëndësi është të theksohet se lufta menjëherë pas betejës së Prekazit, hyri në një dinamikë mësymëse. Njësitet e UÇK-së tashmë deklaruan vija fronti, filluan të bëjnë edhe vija të fortifikuara, duke bërë punime fushore në gjithë ato rajone që ishin më të qëndrueshme.

Komanda e forcave të armikut duke parë zhvillimet që po dukeshin në gjithë Kosovën, e pa mirë se situata po i dilte nga dora. Për të parandaluar një shtrirje të mëtejshme dhe një fuqizim të gjithanshëm të UÇK-së, armiku mori masa edhe për të krijuar përçarje midis shqiptarëve. Për këtë, armiku thirri në Kosovë forca paramilitare, që në mesin e marsit 1998, të organizojnë masakra në popullsinë e pambrojtur. Ndërkohë, tentoi të shfrytëzonte edhe fushatën zgjedhore që po zhvillohej në atë kohë në Kosovë për qeverisjen paralele, duke krijuar idenë se ata që luftojnë po prishin punë. Kjo ishte një manovër e armikut për të shkëputur UÇK-në nga populli i saj.

Por, me gjithë përpjekjet nuk u arrit të ndalen goditjet e luftëtarëve të lirisë të cilët sipas programit të tyre ndërморën goditje

dhe po deklarorin çdo ditë se ishin në gjendje të vazhdonin luftën me të gjitha mjetet deri në çlirim.

Disa vlerësime të nevojshme

Sot, megjithëse është bërë një luftë, kanë rënë mbi 2000 dëshmorë të atdheut, u ekzekutuan edhe mbi 15 mijë civilë, u dogj e gjithë Kosova, pati mbi 1.5 milion të shpërngulur nga shtëpitë e edhe jashtë Kosovës. Duket se ajo krisëm e fuqishme dhe ajo gjëmë e madhe, nuk po dëgjohen më si duhet e si kanë ndodhur. Disa duket se do të kishin dëshirë që luftën t'ua sillnim në televizor në shtëpi. Ndoshta dikush mendon se lufta bëhet me kamera e me aparate filmimi, e jo me pushkë. Gabojnë rëndë. Lufta donë forcë, lufta donë zemër, lufta donë qëndresë, lufta donë gjak, lufta donë armë. Kush e donë luftën në televizor le të vazhdojë me të tijën. Ne nuk kemi kohë të humbasim me të dhe nuk na duhet fare vlerësimi i tij. Po duket se ajo periudhë është diçka e kaluar, që nuk ka më nevojë të merremi me të, që mund edhe të harrohet, që nuk ia vlen të harxhohet kohë për ta përkujtuar e analizuar.

Është shumë prezent fakti që këta luftëtarë të lirisë nuk ishin legjionar, apo profesionist të ushtrisë me përvojë profesionale e me përvojë luftarake, por ishin djem e vasha të këtij populli, të thjeshtë, që ndoshta sot kur i shikojmë rrugëve të qytetit apo fshatrave nuk na duken interesant, ama ata ishin djemtëe vashat që i futën tmerrin armikut. Ata ishin djemtë që bënë jehonë, që krijuan atë bindje tek të gjithë, se të luftosh Serbinë e të vrasësh serbët, nuk është e pamundur, siç ishte injektuar prej një shekulli në jetën e popullit.³¹

³¹*Po aty.*

Le të ulen analistët dhe profesionistët ushtarakë të akademive klasike dhe të japin përgjigje profesionale për betejën e Jasharajve. Le të thonë, mbi çfarë baze llogarish mund të dilet nëpërfundimin se si fitohet lufta kur armiku vetëm tanke ka më shumë se sa janë të gjithë luftëtarët e lirisë në betejë, kur armiku artileri ka sa dyfishin e luftëtarëve të lirisë në betejë, kur armiku ka ushtarë 66 herë më shumë se sa janë luftëtarët e lirisë në betejë, kur armiku ka disa dhjetëra e pse jo qindra kuadro me akademi ushtarake përballë luftëtarëve të lirisë që kanë kryer vetëm akademinë e luftës çlirimtare. Le të marrin specialistët në analizë e të japin përfundime. Kjo është krenaria jonë. Kjo është lufta jonë. Kjo është fitorja jonë. Kjo është vlera jonë. Jemi krenarë që ishim pjesë e saj dhe bashkëkohës të këtyre personazheve me fuqi e vlera të jashtëzakonshme kombëtare.³²

Luftëtarit i ka takuar lavdia e luftës së fituar. Dëshmorit i ka takuar pavdekësia. Të dyja janë vlera të mëdha. Por, neve na ka takuar t'i mbajmë këto vlera e t'i transmetojmë nga e sotmja në të nesërmen. Le ta pyesim veten: A jemi në gjendje ta kryejmë këtë detyrë të madhe? Nëse jo, të mos bëhemi pengesë ta kryejnë ata që kanë shpatulla e forcë për të mbajtur pesha të tilla të rënda lavdie e pavdekësie.³³

Lexojmë sot shumë për luftën. Shkruajnë edhe luftëtarët, por ata megjithëse ndoshta nuk shkruajnë bukur, thonë atë që kanë parë e përjetuar. Shkruajnë ndoshta diçka më shumë për veten, por më duket normale, pasi secili më afër sheh më mirë dhe kuptohet, që atë të cilën e sheh më mirë edhe do të të duket më e madhe e më e ndritur. Prandaj, nuk më duket shumë interesante që dikush shkruan dy fjalë më tepër

³²Kudusi Lame, *Beteja e Jeshkovës - tregues i forcës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, Kumtesë, Prizren 2011, f. 2.

³³*Po aty.*

për veten. Por, kur shkruajnë disa që nuk kanë pasur guximin të bëhen pjesë e luftës dhe vlerësojnë se luftëtarët nuk i kanë bërë mirë veprimet gjatë betejave, se po të ishte bërë kështu e kështu do të ishte më mirë, se po të kishin dalë këtu e këtu humbjet do të ishin më të vogla etj. Kur shkruajnë disa edhe pa emra të vërtetë në media e edhe në internet, se në luftë ka pasur edhe nga ata që na qenkan trembur e edhe nga ata që kanë pasur frikë, se të tillëve u dashka bërë haram gjiri i nënës, se ata qenkan të mjerë, se ata e paskan haram që shkelin tokën e Kosovës, se ata e paskan haram ajrin e Kosovës etj. Këto më duken banalitetet të kohës, që nuk duhet t'i lejojmë të ndodhin. Të tillëve është mirë t'u tregojmë vendin.³⁴

Sot, vlerësohet se Adem Jashari dhe Jasharajt e tjerë lëkundën globin nga vendi. Me ta nisi epoka e re, epoka e madhe e lirisë. Secili që shkeli në truallin e shqiptarëve u mahnit nga madhështia heroike e atyre që u shkrinë deri në një dhe i dhanë jetë lirisë. BernarKushner erdhi aty dhe pasi u ul në odën e Jasharajve, e tha: “Sikur të kishte çmim Nobel për Liri, ai me siguri do t'i takonte familjes Jashari”.

Përfundime të përgjithshme

Duke marrë në analizë vlerat e luftës së Jasharajve, dalim në disa përfundime, prej të cilave më kryesore konsideroj:

1. Trupat serbe, si rrjedhojëe operacioneve mësymëse të zhvilluara gjatë viteve 1990-1998, duke vënë në veprime luftarake edhe njësi tankiste e aviacion, mundën të bënin masakra të rënda mbi popullsinë shqiptare në Kosovë e më gjerë. Me synim të caktuar të krijonin mundësi për ndryshimin e raportit demografik në territoret e

³⁴*Po aty.*

pushtuara shqiptare, kryesisht në Kosovë. Megjithatë, nuk e arritën qëllimin kryesor. Kjo shpjegohet për faktin, se shqiptarët me luftëtarët e tyre u shkaktuan forcave serbe humbje të mëdha në forca e në teknikë luftarake, duke mos u dhënë asnjë mundësi të vazhdonin ekzekutimin e mëtejshëm. Komandanti Adem Jashari, bëri atë qëndresë, që u bë modeli i rezistencës antiserbe dhe siguri e lirisë së Kosovës.

Nga anatjetër, Ushtria Çlirimtare e Kosovës mori impulsin e fuqizimit të saj, mori injeksionin për t'u bërë fuqia e armatosur e shqiptarëve deri në fitoren përfundimtare kundër Serbisë, duke bërë të mundur krijimin e frontit të pashkëputur e të dendur të gjithë shqiptarëve, si dhe marrjen e iniciativës së serbëve në frontet e luftimeve.

2. Veprimet luftarake për mbrojtjen e fisit të Jasharajve, treguan në mënyrë bindëse se bazat e luftës për çlirim, qëndron në këmbënguljen, qëndrueshmërinë dhe aktivitetin e trupave, në drejtimin e tyre me mjeshtëri dhe zgjuarsi, në përdorimin e mjeteve, të formave dhe të metodave më të efektshme të luftimit të bashkërenduara me mbështetjen e gjithë popullit.

3. Gjatë luftës mbrojtëse të Jasharajve, u përkufizua përfundimisht karakteri popullor i luftës për çlirimin e trojeve shqiptare. Këtu, e mori vesh përfundimisht Serbia se nuk kishte të nesërme për të në Kosovë. Karakteri popullor i luftës u duk qartë sidomos pas rënies së Jasharajve, duke e kthyer këtë rënie në fuqi të luftës kombëtare, nëpërmjet fuqizimit të radhëve të UÇK-së.

4. Radhët e luftëtarëve, si gjatë luftës së Jasharajve ashtu edhe gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, bënë një kombinim intensiv e të vazhdueshëm të luftës frontale me luftën në prapavijë të serbëve, duke u dhënë ndihmë të madhe betejave frontale. Ato goditnin në befasi

forcat dhe teknikën e armikut në rajonet e përqendrimit, në rrugëkalime etj.

5. Lufta e Jasharajve tregoi se baza e luftërave mbrojtëse dhe çlirimtare e shqiptarëve, e guximit dhe e heroizmit masiv popullor, ishin atdhedashuria e thellë, vetitë e larta morale dhe aftësitë e mjeshtëria luftarake e shqiptarëve.

6. Lufta e Jasharajve ishte me vlera të jashtëzakonshme, sepse aty u ndeshën 60 luftëtarë shqiptarë (të cilët ishin burra, gra, pleq e plaka, vasha e djem dhe fëmijë), të cilët u ndeshën me forcat serbe që vetëm në rrethimin e brendshëm të tyre ishin 4000 trupa. Prej këtej del se, përballë çdo luftëtari shqiptar, ani pse mund të ishte fëmijë a plak, sulmonin 67 ushtarë serbë. Dhe këta sulmues ishin ushtarë profesionistë, kurse nga luftëtarët e Jasharajve pak kush ishte stërvitur ushtarakisht, për të mos thënë se në atë masë luftëtarësh të rrethuar ishte stërvitur ushtarakisht vetëm Adem Jashari. Dhe kjo luftë ka zgjatur 3 ditë, janë plotë 72 orë. Në këto 3 ditë luftëtarët shqiptarë kanë luftuar, kanë ngrënë, kanë pirë ujë, kanë kryer nevojat fiziologjike, kanë flegjumë dhe nuk kanë lënë të hyjnë në hapësirat që i kanë kontrolluar forcat serbe, përveç që i kanë asgjësuar në masë. Për 3 ditë kanë rënë mbretëri, perandori dhe shtete e janë shuar përgjithmonë. Kurse Jasharajt, për 3 ditë mundën Serbinë, trimëruan shqiptarët, tronditën botën dhe kthyen përfundimisht rrjedhën e ecjes kombëtare shqiptare njëherë e përgjithmonë.

